Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo

Ndihma Juridike / Pravna Pomoć
Legal Aid

AGJENCIA PËR NDIHMË JURIDIKE FALAS
AGENCIJA ZA BESPLATNU PRAVNU POMOĆ
AGENCY FOR FREE LEGAL AID

Raporti Vjetor
Godišnji Izveštaj
Annual Report

2014

PËRMBAJTJA

1. Përmbledhja Ekzekutive 3
2. Korniza ligjore 4
3. Përshkrimi i institucionit - Agjencia për Ndihmën Juridike Falas 5
3.1. Vizioni 7
3.2. Misioni 7
4. Organizimi institucional 7
4.1. Këshilli për Ndihmë Juridike Falas 7
4.2. Përbërja e Këshillit për Ndihmë Juridike Falas 8
4.3. Kompetencat dhe përgjegjësitë e Këshillit për Ndihmë Juridike Falas 8
4.4. Aktivitetet e Këshillit për ndihmë Juridike Falas 9
5. Zyra e Drejtorit Ekzekutiv 11
5.1. Drejtori Ekzekutiv 11
5.2. Aktivitetet e Zyrës së Drejtorit Ekzekutiv, ... 12
6. Bashkëpunimi i ANJF-së me institucionet vendore dhe ndërkombëtare 14
6.1. Memorandumet e Bashkëpunimit 14
6.2. Bashkëpunimi i Agjencisë për Ndihmë Juridike Falas me Odën e Avokatëve 14
6.3. Bashkëpunimi me institucionet ndërkombëtare 15
7. Zyra e Administratës Qendrore e ANJF-së 15
7.1. Burimet Njerëzore 16
7.2. Trajnimet 16
7.3 Mësimi praktike 17
7.4. Teknologjia informative 17
7.5. Arkiva 17
8. Struktura organizative e Agjencisë për Ndihmë Juridike Falas 18
9. Zyrat Rajonale për Ndihmë Juridike Falas 21
9.1. Kompetencat dhe përgjegjësitë e Zyrave Rajonale për Ndihmë Juridike Falas (ZRNJF) 22
9.1.a. ZRNJF në Prishtinë 23
9.1.b. ZRNJF në Prizren 23
9.1.c. ZRNJF në Pejë 24
9.1.d. ZRNJF në Mitrovicë 25
9.1.e. ZRNJF në Gjilan 26
10. Aktivitetet e zyrës së prokurimit 33
11. Auditimi 34
12. Sfidat në sistemin e ndihmës juridike 35
13. Rekomandimet 36

1. Përmbledhja Ekzekutive

Ndihma Juridike Falas fillimisht është ofruar nga Agjencia Evropiane për Rindërtim prej vitit 2001-2005, nëpërmjet Projektit "Ndihma juridike falas në çështje civile dhe administrative", të implementuar nga Oda e Avokatëve të Kosovës, e të realizuar nga OJQ-të vendëse. Pas përfundimit të Projektit, nga raportet e paraqitura është konstatuar se më shumë se gjysma e popullatës së Kosovës ka nevojë për ndihmë juridike falas.

Për këtë arsye, Agjencia Evropiane për Rindërtim financoi edhe Projektin "Krijimi i sistemit gjithëpërfshirës të ndihmës juridike falas në Kosovë", të realizuar nga Agjencia Gjermane Instituti ICON. Realizimi i Projektit luajti rol të rëndësishëm në institucionalizimin e Ndihmës juridike në vendin tonë.

Në vitin 2006 është themeluar Komisioni për Ndihmë Juridike(KNJ), i cili ka vepruar në bazë të Rregullores së UNMIK-ut 2006/36 për Ndihmë Juridike , kurse në vitin 2012 në pajtim me Ligjin nr. 04/L-017 për Ndihmë Juridike Falas është themeluar Agjencia për Ndihmë Juridike Falas(ANJF) dhe është zgjedhur Këshilli i Ndihmës Juridike Falas (KNJF). Në vitin 2013 është emëruar Drejtori Ekzekutiv.

ANJF-a vazhdon të jetë institucioni më i rëndësishëm në sistemin e integruar të ndihmës juridike, në drejtim të ofrimit të ndihmës juridike falas. Numri dhe llojllojshmëria e kërkesave të shfrytëzuesve të ndihmës juridike, tregojnë nevojën dhe rëndësinë e qëndrueshmërisë së këtij institucioni.

Ligji për Ndihme Juridike Falas rregullon krijimin e një sistemi funksional për ndihmë juridike falas, në procedurën civile, penale, administrative dhe kundërvajtëse, nëpërmes së cilit sigurohet qasja efektive në drejtësi për qytetarët të cilët nuk kanë mjete të mjaftueshme financiare. Më përkrahje financiare donatoret : UNDP, Ambasada Mbretërore e Norvegjisë, dhe OSBE kanë kontribuar ne avancimin ofrimin e shërbimeve të ndihmës juridike falas si : në shtrirje territoriale, në gjithëpërfshirje dhe në menaxhim më cilësor të shërbimeve.

Falë bashkëpunimit të ANJF-së më UNDP më qëllim të shtrirjës së ndihmës juridike në tërë territorin e Republikës së Kosovës, janë hapur 8 zyra në komuna të ndryshme të Republikës së Kosovës, në të cilat ofrohet ndihma juridike falas, rreth 40 % te të gjitha rasteve. Mbështetja financiare nga ana e UNDP ka përfunduar në maj te vitit 2014, mirëpo rihapja e zyrave për ndihmë juridike falas është bërë në dhjetor të vitit 2014, falë mbështetjes së Ambasadës Mbretërore të Norvegjisë.

Aktualisht ndihma juridike falas shtrihet në 13 komuna: 5 (pesë) zyra financohen nga buxheti i Republikës se Kosovës si : Prishtinë, Prizren, Pejë, Mitrovicë dhe Gjilan. ANJF prej dhjetorit të vitit 2014 ka realizuar Projektin "Qasja e Barabarte ne Drejtësi" të financuar nga Ambasada Mbretërore e Norvegjisë. Projekti ka mundësuar që ndihma juridike falas të shtrihet edhe në 8 (tetë) komuna tjera: Ferizaj, Graçanicë, Dragash, Gjakovë, Klinë, Mitrovicë (pjesa veriore), Skenderaj dhe në Kllokot.

ANJF në arritjen e objektivave është ballafaquar me sfida të konsiderueshme, në rend të parë më mungesë të buxhetit, për shtrirjen e ndihmës juridike në tërë territorin e Republikës se Kosovës ne pajtim me Ligjin për Ndihme Juridike Falas.

Sfidë e ANJF-se, është inkorporomi i këtyre 8 (tetë) zyrave të Projektit në buxhetin e Republikës së Kosovës, sepse më të përfunduar te përkrahjes financiare nga donatoret, ANJF do të gjendet në pamundësi për të vazhduar me kapacitetet ekzistuese me ofrimin e ndihmës juridike falas në nivel, të cilin ANJF e ka arritur me përkushtim.

Agjencia për Ndihmë Juridike Falas qëndron e përkushtuar, në shërbim të të gjithë atyre të cilët i plotësojnë kriteret e përcaktuara me ligj, për ofrimin e ndihmës juridike falas, veçanërisht parimeve të drejtësisë dhe sundimit të ligjit.

Në drejtim të përmbushjes se misionit të ANJF-së, Zyra e Drejtorit Ekzekutiv, se bashku me grupin punës i cili është formuar me Vendimin e Këshillit për Ndihmë Juridike Falas, ne vitin 2014 kanë hartuar Plani Strategjik 2015-2019, kontribut të veçantë në hartimin e Planit Strategjik ka dhënë edhe OSBE.

Plani Strategjik është i përberë prej katër shtyllave kryesore:

1. Shtylla - I - Komunikimi dhe Bashkëpunimi
2. Shtylla - II - Menaxhimi i Financiar
3. Shtylla –III- Menaxhimi i Rasteve
4. Shtylla –IV- Korniza Ligjore dhe Politikave

2. *Korniza Ligjore*

Agjencia për Ndihmë Juridike Falas është themeluar në vitin 2006. Korniza ligjore për funksionimin e ANJF-së është Kushtetuta e Republikës së Kosovës, e cila ndihmën juridike e përcakton si kategori kushtetuese, përkatësisht neni 31 paragrafi 6, definon se "Ndihma juridike falas do t'u mundësohet atyre që nuk kanë mjete të mjaftueshme financiare, nëse një ndihmë e tillë është e domosdoshme, për të siguruar qasje efektive në

drejtësi", si dhe Ligji nr.04/L-017 për Ndihmë Juridike Falas. Ligji rregullon krijimin e një sistemi funksional për ndihmë juridike falas, në procedurën civile, penale, administrative dhe kundërvajtëse,i cili siguron qasjen efektive në drejtësi për qytetarët të cilët nuk kanë mjete të mjaftueshme financiare.

Në pajtim me nenin 4 paragrafi 1 të Ligjit për Ndihmë Juridike Falas, ndihma juridike falas ofrohet në të gjithë territorin e Republikës së Kosovës. Për shkak të mungesës së mjeteve buxhetore, ANJF nuk arrin ofron ndihmë juridike në tërë territorin e Kosovës, prandaj një prej synimeve të saj është shtrirja e ndihmës juridike falas në të gjitha komunat

Agjencia për Ndihmë Juridike Falas ka të miratuara edhe 6 (gjashtë)rregullore të brendshme te cilat janë :

- Rregullorja ANJF -2013/01 e Punës se Këshillit për Ndihmë Juridike Falas
- Rregullorja ANJF -2013/02 për Procedurat e Punës se Komisionit për Ankesa
- Rregullorja ANJF -2013/03 për Përcaktimin e Kualifikimit për Zyrtaret e ZRNJF-së
- Rregullorja ANJF -2013/04 për Angazhimin e Avokateve
- Rregullorja ANJF -2013/05 për Përcaktimin e Kritereve për Ofrimin e Ndihmës Juridike Falas nga OJQ-të
- Rregullorja ANJF -2013/06 për Organizimin e Brendshëm Sistematizimin e Vendeve të Punës në Agjencinë për Ndihmë Juridike Falas.
- Plani Strategjik i ANJF -së, 2015-2019

3. *Përshkrimi i Institucionit – Agjencia për Ndihmë Juridike Falas (ANJF)*

Agjencia për Ndihmë Juridike Falas është institucion i pavarur publik, i cili funksionin dhe përgjegjësinë e vet e ushtron në pajtim me Ligjin Nr. 04/L-017 për Ndihmë Juridike Falas, i cili ka hyrë në fuqi në mars të vitit 2012. Ky Ligj rregullon krijimin e një sistemi funksional për ndihmë juridike falas, në procedurën civile, penale, administrative dhe kundërvajtëse, nëpërmes së cilit sigurohet qasja efektive në drejtësi për qytetarët të cilët nuk kanë mjete të mjaftueshme financiare.

Ne përputhje me Ligjin për Ndihme Juridikë Falas, ndihma juridike falas jepet për këto lloje:

- informatat dhe këshillat juridike lidhur me procedurat ligjore;

- përpilimin e shkresave dhe tërë asistencën tjetër teknike, që ka të bëjë me kompletimin e lëndës; dhe
- përfaqësimin në procedurën civile, penale, administrative dhe kundërvajtëse.

Shërbimet e autorizuara
Shërbimet e autorizuara të ndihmës juridike falas ofrohen në kuadër të ndihmës juridike primare dhe sekondare.

Ndihma juridike primare përfshin shërbimet vijuese:
- informatat dhe këshillat juridike lidhur me procedurat ligjore;
- përpilimin e shkresave dhe tërë ndihmën tjetër teknike që ka të bëjë me kompletimin e lëndës;
- përfaqësimin në procedurën civile, penale, administrative dhe kundërvajtëse;
- mbrojtjen dhe përfaqësimin në të gjitha fazat e procedurës penale;
- informatat dhe këshillat juridike lidhur me procedurat kundërvajtëse;
- informatat, këshillat juridike dhe ndihma në procedurat e ndërmjetësimit, arbitrazhit ashtu siç është paraparë me ligjet në fuqi.

Momentalisht ANJF nuk ofron ndihmë juridike falas për përfaqësimet ne lëmine penale, për mungesë buxheti.
Ndihma juridike sekondare mbulon shërbimet të cilat janë paraparë në nën-paragrafin 2.2. dhe 2.3 te paragrafit 2 te nenit 5 te Ligjit për Ndihme Juridike Falas

Kriteret për dhënien e ndihmës juridike falas
Ndihma juridike falas i ofrohet të gjithë personave të cilët i plotësojnë kriteret e përcaktuara si në vijim:
- kriteri kualifikues;
- kriteri financiar; dhe
- kriteri juridik

Kriteri kualifikues
Sipas kriterit kualifikues, në ofrimin e ndihmës juridike falas kanë të drejtë:

- shtetasit e Republikës së Kosovës, të cilët janë me vendbanim në territorin e Republikës së Kosovës;
- të gjithë personave me qëndrim të përkohshëm në Republikën e Kosovës;
- personat e tjerë të përcaktuar me ligj, apo me rregullat e të drejtës ndërkombëtare, të cilat e obligojnë Republikën e Kosovës;
- personat të cilëve ju ofrohet ndihma juridike falas në bazë të reciprocitetit.

Kriteri financiar
Sipas kriterit financiar, ofrohet ndihma juridike:
- primare; dhe
- sekondare.

Ndihma juridike primare u ofrohet të gjithë personave të cilët përfitojnë të drejtën nga ndihma sociale, ose janë në situatë të ngjashme me personat që përfitojnë të drejtën nga ndihma sociale.
Ndihma juridike sekondare u ofrohet të gjithë personave, të ardhurat e përgjithshme familjare të të cilëve janë më të vogla se sa të ardhurat mesatare familjare.

Kriteri juridik
Sipas kriterit juridik, ofrohet ndihma juridike duke vlerësuar bazueshmërinë e rastit si;

- vlerën reale të kërkesës;
- fuqia argumentuese e provave të prezantuara nga kërkuesi; dhe
- mundësia e suksesit të kërkesës

3.1 Vizioni

Personat me nevojë dhe grupet e margjinalizuara në Republikën e Kosovës kanë qasje të barabartë në drejtësi, dhe ju ofrohet ndihma juridike falas cilësore nga ANJF-ja dhe partnerët e saj.

3.2 Misioni

Agjencia për Ndihmë Juridike Falas është e përkushtuar të ofrojë ndihmë juridike falas, duke siguruar qasje të barabartë në drejtësi për të gjithë, qytetarët e Republikës së Kosovës, veçanërisht për grupet e margjinalizuara dhe do të :

1. Bashkëpunojë me të gjithë ofruesit e ndihmës juridike falas duke përmirësuar komunikimin ndërmjet ofruesve të ndihmës juridike falas dhe përfituesve të saj ;
2. Ngritë vetëdijen e qytetarëve për punën e Agjencisë dhe njohjen e nevojave të tyre ;
3. Siguron mjete materiale financiare të nevojshme për funksionimin e mirëfilltë të ANJF-së dhe siguron se ANJF-ja ofron ndihmë juridike falas në pajtim me ligjet vendore dhe aktet ndërkombëtare;
4. Ndërmerr hapa të sigurt në përmirësimin e strukturës legjislative, me të cilën rregullohet fusha e ndihmës juridike falas dhe rrit nivelin e administrimit operativ të ANJF-së ;

4. Organizimi Institucional

4.1. Këshilli për Ndihmë Juridike Falas

Në bazë të Ligjit për Ndihmë Juridike falas është formuar Këshilli për Ndihmë Juridike Falas (në tekstin e mëtejmë Këshilli), i cili është kompetent për sigurimin e ndihmës juridike falas.

Këshilli është institucion themelor i cili kryen funksionet e tij në mënyrë të pavarur nga institucionet tjera publike dhe pa udhëzime dhe ndërhyrje nga asnjë person, si dhe

ushtron mbikëqyrjen e drejtpërdrejtë të Agjencisë. Kompetencë dhe përgjegjësi themelore e Këshillit është hartimi i politikave dhe rregullave për ofrimin e ndihmës juridike falas që sigurojnë sistem efektiv, gjithëpërfshirës, fleksibil dhe të qëndrueshëm.

4.2. Përbërja e Këshillit për Ndihmë Juridike Falas

Anëtarët e Këshillit janë zgjedhur nga Kuvendi i Republikës së Kosovës nga radhët e kandidatëve të propozuar nga institucionet e parapara me nenin 11, paragrafi 3 të Ligjit për Ndihmë Juridike Falas.

Këshilli për Ndihmë Juridike Falas përbëhet prej 7 (shtatë) anëtarëve. Këshilli nga radhët e veta zgjedhe Kryesuesin dhe Zv. Kryesuesin.

Nr.	Emri dhe mbiemri	Pozita	Institucioni	Mandati	Skadimi i mandatit
1.	Armend Krasniqi	Kryesues	Oda e Avokateve të Kosovës	3 vjeçar	08.11.2015
2.	Bahrije Berisha	Zv. Kryesuese	Ministria e Financave	3 vjeçar	08.11.2015
3.	Alban Sutaj	Anëtar	Ministria e Drejtësisë	3 vjeçar	08.11.2015
4.	Nenad Stojcetovic	Anëtar	Ministria për Komunitete dhe Kthim	3 vjeçar	08.11.2015
5.	Shukrije Gashi	Anëtare	Rrjeti i Grave te Kosovës	3 vjeçar	08.11.2015
6.	Afrim Shala	Anëtar	Gjykata Supreme	3 vjeçar	08.11.2015
7.	Pozite e paplotësuar		Ministria për Pune dhe Mirëqenie Sociale	3 vjeçar	08.11.2015

4.3. Kompetencat dhe përgjegjësitë e Këshillit

Në përputhje me Ligjin për Ndihme Juridike Falas, KNJF ka këto kompetenca dhe përgjegjësi :

- Hartimin e politikave dhe rregullave për ofrimin e ndihmës juridike falas, që sigurojnë sistem efektiv, efikas, gjithëpërfshirës, fleksibil dhe të qëndrueshëm;
- ushtrimin e mbikëqyrjes së punës së Agjencisë dhe funksionimit gjithëpërfshirës të sistemit të ndihmës juridike falas;
- identifikimin e prioriteteve në ofrimin e ndihmës juridike falas në varësi të burimeve dhe mjeteve financiare në dispozicion.

4.4. Aktivitetet e Këshillit për Ndihmë Juridike Falas

Këshilli për Ndihmë Juridike Falas gjatë vitit 2014 ka mbajtur gjithsej 12 (dymbëdhjetë) takime te rregullta dhe 1(një) takim të jashtëzakonshëm, në kuadër të këtyre takimeve janë nxjerr 7 (shtatë) vendime.

Vendimet e Këshillit janë s i vijon :

V E N D I M

I. APROVOHET Raporti i Punës së Agjencisë për Ndihmë Juridike Falas për vitin 2013.

A r s y e t i m

Në pajtim me nenin 13 par. 4 të Ligjit 04/L-017 për Ndihmë Juridike Falas, KNJF i raporton Kuvendit të Republikës së Kosovës një herë në vit për punën a Agjencisë për Ndihmë Juridike Falas dhe publikon raportin në faqen zyrtare të Agjencisë.

V E N D I M

II. Z. Armend Krasniqi emërohet në pozitën e Kryesuesit të KNJF-së

A r s y e t i m

Këshilli për Ndihmë Juridike Falas në takimin e rregullt, të mbajtur me dt. 10.06.2014, në pajtim me nenin 15, pika 2 i Ligjit 04/L-17 për Ndihmë Juridike Falas, si dhe në bazë të nenit 15 të Rregullores të punës së KNJF-se, zgjodhi Kryesuesin e KNJF-së dhe vendosi si në dispozitivin e këtij Vendimi.

V E N D I M

III. Formohet grupi punues për hartimin e planit strategjik për ndihme juridike falas ne këtë përbërje:

- Z. Alban Sutaj – Kryetar
- Z. Nenad Stojcetovic – Anëtar
- Znj. Shukrije Gashi – Anëtare
- Z. Ramadan Gashi - Anëtar
- Znj. Drita Rexhepi - Anëtar
- Znj. Anita Kalanderi – Anëtar

A r s y e t i m

Në pajtim me nenin 13, pika 2 të Ligjit 04/L-017 për Ndihmë Juridike Falas, Këshilli sipas nevojës themelon komisione të veçanta për ushtrimin e kompetencave të parashtruara në paragrafin 1. të këtij neni.

V E N D I M

IV. Formohet Komisioni për shqyrtimin e ankesave me këtë përbërje:

- Znj. Bahrije Berisha – Kryetare
- Z. Nenad Stojcetovic – Anëtar
- Z. Afrim Shala – Anëtar

A r s y e t i m

Në pajtim me nenin 13, pika 3 të Ligjit 04/L-017 për Ndihmë Juridike Falas, Këshilli formon Komisionin për ankesa, i cili vendos në shkallë të dytë për ankesat e ushtruara ndaj vendimeve të nxjerra nga zyrat rajonale për ndihmë juridike falas.

V E N D I M

V. Znj. Bahrije Berisha emërohet në pozitën e Zëvendës Kryesuesit të KNJF-së

A r s y e t i m

Këshilli për Ndihmë Juridike Falas në takimin e rregullt, të mbajtur me 18 dhjetor 2014, në pajtim me nenin 15, pika 2 i Ligjit 04/L-17 për Ndihmë Juridike Falas, si dhe në bazë të nenit 15 të Rregullores të punës së KNJF-se, zgjodhi Zëvendës Kryesuesin e KNJF-së dhe vendosi si në dispozitivin e këtij Vendimi

V E N D I M

VI. Aprovohet Plani Strategjik i Agjencisë për Ndihmë Juridike Falas 2015-2019

A r s y e t i m

Këshilli për Ndihmë Juridike Falas në takimin e jashtëzakonshëm, të mbajtur me 26 dhjetor 2014, në pajtim me nenin 13 paragrafi 1dhe 2 i Ligjit 04/L-017 për Ndihmë Juridike Falas, si dhe nenit 15 të Rregullores të punës së KNJF-se, lidhur me Planin Strategjik të Agjencisë për Ndihmë Juridike Falas 2015-2019, vendosi si në dispozitivin e këtij Vendimi.

V E N D I M

VII. Rihapen tetë zyrat e Ndihmës Juridike Falas në pajtim me projekt propozimin e dorëzuar nga Agjencia për Ndihmë Juridike Falas dhe të aprovuar nga Ambasada Norvegjeze

A r s y e t i m

Këshilli për Ndihmë Juridike Falas në takimin e jashtëzakonshëm, të mbajtur me 26 dhjetor 2014, në pajtim me nenin 13 dhe nenin 19 paragrafi 4, nën paragrafi 4.2 i Ligjit 04/L-017 për Ndihmë Juridike Falas, si dhe nenit 15 të Rregullores të punës së KNJF-se, lidhur me rihapjen e tetë zyrave të ndihmës juridike falas të cilat kanë qenë të financuara nga UNDP "Projekti Avancimi i Drejtësisë Gjinore" deri më 30 qershor 2014, e që në muajin dhjetor 2014 Ambasada Norvegjeze ka aprovuar projekt propozimin e ANJF-së për financimin e këtyre tetë zyrave, vendosi si në dispozitivin e këtij Vendimi.

5. Zyra e Drejtorit Ekzekutiv (ZDE)

Zyra e Drejtorit Ekzekutiv është zyrë qendrore në sistemin e ndihmës juridike falas. Është përgjegjëse për administrimin e sistemit të ndihmës juridike, mbikëqyrjen e zyrave rajonale për ndihmë juridike falas, mbikëqyrjen e punës për të gjithë të punësuarit në ANJF.

Bashkëpunon me të gjitha institucionet, organizatat vendore dhe ndërkombëtare, me qëllim të avancimit të ofrimit të ndihmës juridike falas.

ZDE në kontinuitet ka zhvilluar aktivitetet e veta dhe i është përmbajtur procedurave standarde të veprimit të përcaktuara në Ligjin Nr.04/L-017 për Ndihmë Juridike Falas, duke i ofruar ndihmë juridike të drejtpërdrejtë, qytetareve të Republikës se Kosovës me gjendje të vështire ekonomike, dhe njëkohësisht duke siguruar se ndihma juridike e ofruar është e efektshme, efikase, gjithëpërfshirëse, fleksibile dhe e qëndrueshme. Në këtë mënyrë qytetarëve që i plotësojnë kriteret e përcaktuara më ligj, u është mundësuar qasja e barabartë në drejtësi.

ANJF është përkujdesur që në emër të drejtësisë, te të gjithë siguruesit e ndihmës juridike të krijohet vetëdija e mbrojtjes së interesave për të gjithë qytetarët, të cilëve për shkak të mungesës së mjeteve materiale i është mohuar qasja e barabartë në drejtësi, sidomos grupeve të cenueshme (fëmijëve, viktimave të dhunës familjare, të moshuarave, personave me aftësi të kufizuara, të zhvendosurave etj.) përmes ofrimit të ndihmës juridike falas.

5.1. Drejtori Ekzekutiv

Drejtori Ekzekutiv është organ i Agjencisë, kompetencat dhe përgjegjësit e Drejtorit Ekzekutiv janë përcaktuar me Ligjin për Ndihme Juridike Falas të cilat janë :

- koordinon punën e sistemit të ndihmës juridike falas;
- përgatit propozimin e buxhetit vjetor të Agjencisë;
- propozon strukturën organizative të Agjencisë për miratim nga Këshilli;
- punëson dhe mbikëqyre punonjësit e Agjencisë;
- kontrakton mallra dhe shërbime për funksionimin e sistemit të ndihmës juridike falas;
- organizon trajnime për ofruesit e ndihmës juridike falas;
- udhëheq fushata të vetëdijesimit për sistemin e ndihmës juridike falas;
- përgatitë raporte të rregullta vjetore dhe raporte të tjera sipas kërkesës së Këshillit

- mbanë regjistra dhe ruan dokumente dhe të dhëna lidhur me funksionimin e Agjencisë.

Drejtori ekzekutiv për punën e tij i përgjigjet Këshillit.

5.2. Aktivitetet e Zyrës së Drejtorit Ekzekutiv

ZDE-ja ka arritur të ofrojë dhe në përgjithësi të sigurojë shërbime administrative, teknike, si dhe shërbime tjera mbështetëse për ANJF-në, duke realizuar menaxhimin efektiv dhe efikas të punëve. Gjithashtu, në drejtim të arritjes së objektivave specifike të punës, ka koordinuar, ka mbikëqyrur dhe ka përcjellë punën e Zyrës së Administratës Qendrore, Zyrës së Personelit, të Prokurimit, Teknologjisë Informative dhe Arkivit.

Angazhimi i ZDE-së ka qenë i drejtuar vazhdimisht në ofrimin e përkrahjes administrative për funksionim të rregullt të takimeve të Këshillit për Ndihmë Juridike Falas, duke i zbatuar të gjitha vendimet e nxjerra nga Këshilli.

Gjatë kësaj periudhe raportuese, Zyra e Drejtorit Ekzekutiv për ndihmën juridike (ZDE) në kontinuitet ka zhvilluar aktivitetet e veta dhe i është përmbajtur procedurave standarde të veprimit te përcaktuara në Ligjin Nr.04/L-017 për Ndihmë Juridike Falas, duke i ofruar ndihmë juridike të drejtpërdrejtë, qytetareve të Republikës se Kosovës me gjendje të vështire ekonomike, dhe njëkohësisht duke siguruar se ndihma juridike e ofruar është e efektshme, efikase, gjithëpërfshirëse, fleksibile dhe e qëndrueshme. Në këtë mënyrë qytetarëve që i plotësojnë kriteret e përcaktuara më ligj, u është mundësuar qasja e barabartë në drejtësi.

ANJF në periudhën raportuese ka zhvilluar një varg takime me institucionet vendore dhe ndërkombëtare, kryesisht qëllimi i këtyre takimeve ka qenë i lidhur ngushtë me gjetjen e donacioneve, për vazhdimin e funksionimit te zyrave të cilat deri në maj të vitit 2014 kanë qenë të mbështetura nga UNDP. Këtë fakt e i lustrojnë takimet e shumta me: Përfaqësues te Kuvendit te Republikës se Kosovës, Zyrës se Kryeministrit, Ministrisë se Drejtësisë, UNDP, Komisionin Evropian, USAID-in, Ambasadën Norvegjeze, OSBE etj.

Ajo që e karakterizon punën e ZDE-së apo të ANJF-së, për periudhën raportuese, është përpjekja e vazhdueshme në, për nevojën e inkorporimit të zyrave nga Projekti i UNDP në ANJF, si zyre të rregullta, në drejtim të sigurimit të qëndrueshmërisë së tyre, në mënyrë të shtrirjes më efikase të ndihmës juridike falas, në tërë territorin e Republikës së Kosovës.

ZDE, për të siguruar qëndrueshmëri te ndihmës juridike ka organizuar Konferencën me temën "**Qëndrueshmëria e Ndihmës Juridike Falas"** konferencë e cila është mbështetur nga UNDP, ku pjesëmarrës kanë qenë afër 80 përfaqësues të institucioneve vendore dhe ndërkombëtare.

Si rekomandim i kësaj konference ka rezultuar, që të bëhet identifikimi specifik i nevojave për qëndrueshmërinë e ndihmës juridike. Si rezultat i kësaj ANJF ka përpiluar projekt propozime, me të cilat ka aplikuar të donatorë të ndryshëm. Nga kjo përpjekje ka rezultuar me sukses hapja e 8 (tetë) zyrave me përkrahjen financiare nga Ambasada Mbretërore Norvegjeze për një periudhë 6 (gjashtë) mujore

ZDE i ka kryer të gjitha punët më përgjegjësi për çështjet operative ditore, të lidhura me shërbimet e ofruara të ndihmës juridike, për administrimin e sistemit të ndihmës juridike dhe mbikëqyrjen e zyrave për ndihmë juridike falas.

ZDE ka menaxhuar dhe mbikëqyrë punët, për të gjithë të punësuarit në ndihmën juridike, ka mbajtur takimet e rregullta të stafit menaxhues, me përfaqësuesit e ZRNJF-së, me qëllim të forcimit të komunikimit dhe referimit efikas të rasteve.

Në vazhdimësi është monitoruar puna ZRNJF-as, procedimi i lëndëve respektimi i afateve, angazhimi i avokateve etj.

ZDE, se bashku me grupin punës i cili është formuar me Vendimin e Këshillit për Ndihmë Juridike Falas, në vitin 2014 kanë hartuar Plani Strategjik 2015-2019, kontribut të veçantë në hartimin e Planit Strategjik ka dhënë edhe OSBE.

Plani Strategjik është i përberë prej katër shtyllave kryesore:

5. Shtylla - I - Komunikimi dhe Bashkëpunimi
6. Shtylla - II - Menaxhimi i Financiar
7. Shtylla –III- Menaxhimi i Rasteve
8. Shtylla –IV- Korniza Ligjore dhe Politikave

6. *Bashkëpunimi i ANJF-se, me institucionet vendore dhe ndërkombëtare*

Me qëllim të sensibilizimit dhe promovimit të punës të ANJF-së, janë mbajtur një varg takimesh me institucionet vendore dhe ndërkombëtare, ndër më të rëndësishmet ka qenë

takimi me përfaqësues të Kuvendit te Republikës se Kosovës, përfaqësues të ministrive, përfaqësues të komunave konkretisht në komunat ku vepron ANJF, Institucionin e Avokatit te Popullit, OAK, UNDP, OSCE, UNICEF, USAID, Ambasadën Norvegjeze, përfaqësues të shoqërisë civile etj.

6.1 Memorandumet e Bashkëpunimit

Agjencia për Ndihme Juridike Falas gjatë kësaj periudhe raportuese ka nënshkruar 3 (tre) memorandume te bashkëpunimit më :

- Memorandum Bashkëpunimi me Odën e Avokatëve te Kosovës (OAK)
- Memorandum Bashkëpunimi me Kolegji "Iliria"
- Memorandum Bashkëpunimi me OAK, UNICEF dhe Zyra për Mbrojte dhe Ndihmë Viktimave

6.2 Bashkëpunimi i Agjencisë për Ndihmë Juridike Falas me Odën e Avokatëve

Bazuar ne nenin 29 të Ligjit për Ndihme Juridike Falas, avokatët ofrojnë shërbime juridike të autorizuara në kuadër të ndihmës juridike primare dhe sekondare. Oda e Avokatëve të Kosovës përgatitë dhe dorëzon tek Agjencia listën e avokatëve të cilët shprehin gatishmërinë për ofrimin e ndihmës juridike falas. Agjencia lidhë kontratë individuale me avokatët e gatshëm për ofrimin e ndihmës juridike falas. Avokatët ofrojnë shërbimet e autorizuara të ndihmës juridike falas sipas tarifës mbi kompensimet e përcaktuara nga Agjencia me akt nënligjor. Zyrat rajonale për rastet të cilat duhet ti përfaqësojnë pranë gjykatave dhe organeve tjera, përfituesit e ndihmës juridike falas, caktojnë avokatin nga lista e azhurnuar prej Odës së Avokatëve. Procedura për angazhimin e avokatëve rregullohet me akt nënligjor. Shërbimet e autorizuara të përfaqësimit dhe të mbrojtjes në procedura gjyqësore ofrohen vetëm nga avokatet

ANJF-a vazhdon të bashkëpunojë me Odën e Avokatëve të Kosovës në përcaktimin e masave pozitive për të siguruar përfaqësim të drejtë të përfituesve ashtu edhe të ofruesve të ndihmës juridike.

6.3 Bashkëpunimi me institucionet ndërkombëtare

Agjencia për Ndihmë Juridike Falas në kontinuitet ka bashkëpunim të mirëfilltë ndërkombëtar, si rezultat i këtij bashkëpunimi gjate vitit 2014 mund të veçojmë:

Agjencia për Ndihme juridike Falas ka arritur që falë bashkëpunimit ndërkombëtar të gjejë mbështetje financiare, sidomos për shtrirjen territoriale të ndihmës juridike falas. Deri në maj të vitit 2014 tetë zyrat për ndihme juridike falas të cilat veprojnë ne komunën e Gjakovës, Ferizajt, Gracanices, Dragashit, Mitrovicës, Kllokotit, Skenderajt, dhe Klinës janë mbështetur nga Projekti "Avancimi i Drejtësisë Gjinore" UNDP. Pas përfundimit të Projektit nga ana e UNDP, ANJF ka bërë përpjekje të vazhdueshme për të ri funksionalizuar serish zyrat për ndihmë juridike falas. Gjate kësaj periudhe janë zhvilluar një varg aktivitete dhe takime me donatoret e mundshëm për të ri funksionalizuar këto zyra. Në dhjetor të vitit 2014 ANJF ka siguruar përkrahje financiare nga Ambasada Mbretërore e Norvegjisë qe edhe për 6 muaj te ri funksionalizohen këto zyra.

7 Zyra e Administratës Qendrore e ANJF-së

Në Agjencinë për Ndihmë Juridike falas vepron Zyra e Administratës Qendrore e cila është kompetente për:

- Menaxhimin dhe mirëmbajtjen e informatave për burime njerëzore te ANJF-së, Sigurimin dhe zbatimin e procedurave për përzgjedhjen dhe punësimin e personelit te kualifikuar, në përputhje me legjislacionin ne fuqi
- Koordinimin dhe përgatitjen, zbatimin, raportimin dhe vlerësimin e buxhetit te ANJF-së
- Koordinimin dhe zbatimin me kohe të detyrimeve financiare të ANJF
- Mirëmbajtjen e pajisjeve të teknologjisë informative dhe ofrimin e shërbime të teknologjisë informative.
- Menaxhimin e sistemit të arkivit dhe dokumentet e brendshme të ANJF –së
- Ofrimin e shërbimeve logjistike, mirëmbajtjen dhe menaxhimin e hapësirave të punës se ANJF-së.

Drejtori i Zyrës se Administratës Qendrore raporton të Drejtori Ekzekutiv.

7.1 Burimet Njerëzore

Momentalisht stafi i ANJF-së numëron gjithsej 47 të punësuar, prej të cilëve 22 janë shërbyes civil, ndërsa 25 janë të punësuar nga Projekti "Qasja e Barabartë në Drejtësi " financuar nga Ambasada Mbretërore e Norvegjisë.

ANJF-ja në vitin raportues ka rekrutuar 3 (tre) pozita në Shërbimin Civil dhe 1(një) pozitë për Projektin "Qasja e Barabarte ne Drejtësi " financuar nga Ambasada Mbretërorë e Norvegjisë.

Procedurat e rekrutimit janë zhvilluar në pajtim me Ligjin për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës nr. 03/L-149.

Nga numri total i të punësuarve në cilësinë e shërbyesve civil 12 (dymbëdhjetë) janë femra dhe 10 (dhjetë) meshkuj, ndërsa nga të punësuarit nga Projektit "Qasja e Barabarte në Drejtësi " mbështetur nga Ambasada Mbretërore e Norvegjisë, 13 (trembëdhjetë) janë femra dhe 12 (dymbëdhjetë) meshkuj.

Prej gjithsej 47 (dyzetë e shtatë) të punësuarve të komunitetit shqiptar janë 39 (tridhjetë e nëntë), të komunitetit serb janë 4 (katër) , të komunitetit boshnjak 2 (dy) , të komunitetit turk 1 (një) dhe komunitetit ashkali 1(një) .

Gjatë periudhës raportuese marrëdhënien e punës e ka ndërprerë 1(një) zyrtarë, me vet dëshirë.

7.2 Trajnimet

Në periudhën raportuese Zyra e Personelit vazhdon për të kontribuar në ngritjen profesionale të stafit, nëpërmjet trajnimeve të ndryshme, të cilët janë certifikuar, nga institucioni i specializuara: Instituti i Administratës Publike i Kosovës (IKAP). Meqenëse ANJF ofron shërbime juridike falas në lëmin civile, administrative, penale dhe kundervajtese dhe bazuar në llojllojshmërinë e rasteve të cilat deri më tani janë trajtuar, konsiderohet nevojë e domosdoshme trajnimet profesionale. Në Planin Strategjik 2015 – 2019 të hartuar në bashkëpunim me OSBE, është përcaktuar si objektivë kryesore pjesa e trajnimit për stafin menaxherial dhe administrativ. Duke e marrë parasysh se trajnimet për stafin e ANJF, kanë qenë të kufizuara, përmbajtja programore e trajnimit ka për qëllim të thëllojë dhe ndërtojë njohuri, shkathtësi dhe kulturë të përparuar organizative. Duke marrë parasysh specifiken e shërbimit të ANJF-së, stafi i cili ofron shërbime juridike, kanë nevojë për trajnime në mënyrë të vazhdueshme, për të qenë koherent me kërkesat dhe nevojat e qytetareve.

7.3 Mësimi praktik

Në drejtim të realizimit të Marrëveshjes së ANJF-së me Universitetin e Prishtinës (UP) Fakultetin Juridik, ANJF-ja ju ka mundësuar studentëve që janë përzgjedhur nga Fakulteti Juridik, të vijojnë punën praktike në zyrat rajonale për ndihmë juridike falas. Po ashtu gjatë këtij viti raportues ANJF ka lidhur Marrëveshje Mirëkuptimi me Kolegjin "Iliria" qëllimi i të cilit ka qenë që studentet e Fakultetit juridikë te vijojnë mësimin praktik në ANJF.

ANJF-ja ju ka mundësuar edhe studentëve vullnetarë që të kryejnë punën praktike në këtë institucion. Deri me tani më tepër se 70 (shtatë dhjetë) praktikant janë aftësuar profesionalisht me mësim praktik në ANJF.

7.4 Teknologjia Informative

Shërbimi i teknologjisë informative është mirëmbajtur nga zyrtari i IT-së në bashkëpunim me shërbimet kompetente të MAP –it. Shërbimi i teknologjisë informative është përkujdesur për mirëmbajtjen e ueb faqes së ANJF-së, e cila në vazhdimësi freskohet me të dhënat e nevojshme të aktiviteteve të ANJF-së. Poashtu shërbimi i teknologjisë informative është përkujdesur që gjatë vitit 2014 të mirëmbajë bazën e të dhënave e cila funksionin në ANJF.

7.5 Arkiva

Gjatë vitit 2014 në ANJF janë pranuar, regjistruar, protokolluar dhe arkivuar shumë shkresa si për komunikim të brendshëm, për komunikim të jashtëm, si dhe lëndë të avokatëve, si në vijim:

- Shkresa të dërguara 153
- Shkresa të pranuara 52
- Shkresa në komunikim të brendshëm 72
- Lëndët e regjistruara të avokatëve 634
- Shkresa tjera 713

Përveç këtyre janë regjistruar edhe dokumente tjera, ashtu që në ANJF janë të arkivuara gjithsej 1.624 shkresa.

8 Struktura organizative e Agjencisë për Ndihmë Juridike Falas

Agjencia për Ndihmë juridike Falas ka miratuar Rregulloren nr. 06/2013 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Agjencinë për Ndihme Juridikë Falas. Në organogramin e miratuar është paraqitur nevojë për punonjës të ri, për të përmbushur kërkesat e dispozitave ligjore përkatëse për pozita të caktuara, ndërsa në Agjencinë për Ndihme Juridike Falas nuk ekzistojnë. Për te mos u penguar procesi i punës disa nga zyrtarët e ANJF –së, ushtrojnë dy ose me shumë pozita.

Organogrami Ekzistues sipas të cilit momentalisht punon ANJF-ja







Grafikonet paraqesin strukturën etnike dhe gjinore të personelit (shërbyesve civil)te cilët janë punësuar ne ANJF







Grafikonet paraqesin strukturën gjinore dhe etnike të personelit te cilët janë mbështetur nga Ambasada Mbretërorë e Norvegjisë



Organogrami i ANJF se i aprovuar nga KNJF

9. Zyrat Rajonale për Ndihmë Juridike Falas (ZRNJF)

Aktualisht ofrimi i ndihmës juridike falas në Republikës e Kosovës, bëhet nëpërmjet 5 (pesë) zyrave rajonale për ndihmë juridike falas në komunat: Prishtinë, Prizren, Pejë, Mitrovicë dhe Gjilan, dhe 8 (tetë) zyrave për ndihmë juridike të cilat deri në maj të vitit 2014 janë përkrahur nga Projekti 'Avancimi i Drejtësisë Gjinore" UNDP, ndërsa nga dhjetori 2014 përkrahen nga Projekti "Qasja e Barabartë në Drejtësi" – financuar nga Ambasada Mbretërore e Norvegjisë, në: Graçanicë, Ferizaj, Dragash, Gjakovë, Mitrovicë, Kllokot, Skenderaj dhe në Klinë. Rëndësia e funksionimit të këtyre zyrave është e madhe duke marrë parasysh shkallen e varfërisë në Republikën e Kosovës dhe nevojën që qytetarët e Republikës se Kosovës ti realizojnë të drejtat e tyre të cilat u janë mohuar pikërisht për arsye të mjeteve materiale.

Harta me Zyrat për Ndihmë Juridike Falas në Republikën e Kosovës



9.1. Kompetencat dhe përgjegjësitë e ZRNJF-ve

Në zyrat për ndihmë juridike falas, në mënyrë të drejtpërdrejtë i ofrohet ndihma juridike falas, në lëmin civile, administrative, penale dhe kundërvajtëse, të gjithë qytetarëve me gjendje të vështirë materiale të cilët i plotësojnë kriteret e përcaktuara në Ligjin për Ndihmë Juridike Falas.

1. Vendosin mbi kërkesat për ndihmë juridike, ashtu siç parasheh Ligji për Ndihmë Juridike Falas;
2. Ofrojnë ndihmë juridike duke:
    a) Ndihmuar aplikuesit për plotësimin e kërkesës
    b) Kompletuar dokumentet e nevojshme për plotësimin e kërkesës
    c) Vërtetuar informatat lidhur me dokumentet e ofruara
3. Vendosin mbi të drejtën e kërkuesit në përfitimin e ndihmës juridike;
4. Në bazë të gjendjes financiare të kërkuesit vendosin për ofrimin e ndihmës juridike primare, apo sekondare;
5. Vendosin mbi besueshmërinë e rastit;
6. Vendosin nëse ndihma e kërkuar është brenda fushës së shërbimeve të ndihmës juridike;
7. Pranojnë ankesa kundër vendimit mbi refuzimin e ndihmës juridike, duke raportuar Zyrën e Drejtorit Ekzekutiv për Ndihmë Juridike;
8. Angazhojnë avokatë prej listës së ofruar nga Oda e Avokatëve të Kosovës;
9. Gjatë angazhimit të avokatëve nga lista e avokatëve, kujdesen për angazhimin e barabartë të tyre në ofrimin e ndihmës juridike, duke respektuar përvojën dhe lëmin e tyre.

9.1a. Zyra Rajonale për Ndihmë Juridike Falas - P r i sh t i n ë

Rajoni i Prishtinë numëron dymbëdhjetë komuna: Prishtinë, Ferizaj, Podujevë, Lipjan, Drenas, Kaçanik, Hani i Elezit, Fushë Kosovë, Shtime, Kastriot (Obiliq), Shtërpcë dhe Graçanicë.

Në rajonin e Prishtinës ekzistojnë tri zyre për ofrimin e ndihmës juridike falas : Një ZRNJF në Prishtinë, e cila financohet nga Buxheti i Republikës së Kosovës, edhe dy zyra

për ndihmë juridike falas (ZNJF), në: Graçanicë dhe Ferizaj, të cilat deri në maj të vitit 2014, janë mbështetur nga UNDP, ndërsa nga dhjetori i vitit 2014 financohen nga Ambasada Mbretërore e Norvegjisë, me Projektin "Qasja e Barabartë në Drejtësi".

Në tabelën më poshtë është pasqyruar numri i lëndëve sipas lëmisë, strukturës gjinore dhe përkatësisë etnike të përfitueseve të ndihmës juridike falas, në rajonin e Prishtinës, që përfshinë Zyra Rajonale për Ndihmë Juridike Falas (ZRNJF-ja) në Prishtinë dhe Zyrat për Ndihmë Juridike (ZNJ-të) në Ferizaj dhe Graçanicë.

Komuna e Prishtinës mbulon 49 vendbanime

ZRNJF	LËMIA				GJINIA		PËKATËSIA ETNIKE									Nr. i lëndëve
	Administrative	Civile	Kundër vajtse	Penale	M	F	Ashkali	Boshnjak	Egjiptian	Goran	Romë	Serb	Shqiptar	Tjeter	Turk	
Prishtinë	287	291	1	20	251	348	8	6	2	1	0	0	572	1	9	599

Periudhë janar-dhjetor 2014

Komuna e Ferizajt mbulon 63 vendbanime

ZRNJF	LËMIA				GJINIA		PËKATËSIA ETNIKE									Nr. i lëndëve
	Administrative	Civile	Kundër vajtse	Penale	M	F	Ashkali	Boshnjak	Egjiptian	Goran	Romë	Serb	Shqiptar	Tjeter	Turk	
Ferizaj	228	68	6	26	122	206	20	1	0	0	1	1	304	1	0	328

Periudhë janar-dhjetor-2014

Komuna e Graçanicës

ZRNJF	LËMIA				GJINIA		PËKATËSIA ETNIKE									Nr. i lëndëve
	Administrative	Civile	Kundër vajtse	Penale	M	F	Ashkali	Boshnjak	Egjiptian	Goran	Romë	Serb	Shqiptar	Tjeter	Turk	
Graqanicë	34	27	0	0	22	39	0	0	0	0	7	48	5	1	0	61

Periudhë janar-dhjetor-2014

9.1 b. Zyra Rajonale për Ndihmë Juridike Falas - P r i z r e n

Rajoni i Prizren numëron 6 komuna: Prizren, Therandë (Suharekë), Rahovec, Malishevë, Dragash dhe Mamushë.

Në rajonin e Prizrenit ekzistojnë dy zyre për ofrimin e ndihmës juridike falas : Një ZRNJF në Prizren, e cila financohet nga Buxheti i Kosovës, dhe një ZNJ në Dragash, e cila deri në maj të vitit 2014 është mbështetur nga UNDP, ndërsa nga dhjetori i vitit 2014 financohen nga Ambasada Mbretërore e Norvegjisë, me Projektin "Qasja e Barabartë në Drejtësi".

Në tabelë më poshtë është pasqyruar numri i lëndëve sipas lëmisë, strukturës gjinore dhe përkatësisë etnike të përfitueseve të ndihmës juridike falas, në regjionin e Prizrenit , që përfshinë : ZRNJF Prizren dhe ZNJ Dragash

Komuna e Prizrenit mbulon 76 vendbanime

ZRNJF	LËMIA				GJINIA		PËKATËSIA ETNIKE									Nr. i lëndëve
	Administrative	Civile	Kundër vajtse	Penale	M	F	Ashkali	Boshnjak	Egjiptian	Goran	Romë	Serb	Shqiptar	Tjeter	Turk	621
Prizren	307	272	2	40	232	389	9	48	0	0	53	2	480	0	29	

Periudhë janar-dhjetor 2014

Komuna e Dragashit mbulon 36 vendbanime

ZRNJF	LËMIA				GJINIA		PËKATËSIA ETNIKE									Nr. i lëndëve
	Administrative	Civile	Kundër vajtse	Penale	M	F	Ashkali	Boshnjak	Egjiptian	Goran	Romë	Serb	Shqiptar	Tjeter	Turk	140
Dragash	102	34	0	4	21	119	0	0	0	33	0	0	107	0	0	

Periudhë janar-dhjetor 2014

9.1.c Zyra Rajonale për Ndihmë Juridike Falas - P e j ë

Rajoni i Pejës numëron 6 komuna: Pejë, Gjakovë, Klinë, Deçan, Istog dhe Junik

Në rajonin e Pejës ekzistojnë tre zyre për ofrimin e ndihmës juridike falas: Një ZRNJF në Pejë, e cila financohet nga Buxheti i Kosovës, një ZNJ në Gjakovë dhe një ZNJ në Klinë të cilat deri në maj te vitit 2014 janë mbështetur nga UNDP, ndërsa nga dhjetori i vitit 2014 financohen nga Ambasada Mbretërore e Norvegjisë, me Projektin "Qasja e Barabarte në Drejtësi".

Në tabelë më poshtë është pasqyruar numri i lëndëve sipas lëmisë, strukturës gjinore dhe përkatësisë etnike të përfitueseve të ndihmës juridike falas, në regjionin e Pejës, që përfshin: ZRNJF Pejë dhe ZNJF Gjakovë dhe Klinë.

Komuna e Pejës mbulon 79 vendbanime.

ZRNJF	LËMIA				GJINIA		PËKATËSIA ETNIKE									Nr. i lëndëve
	Administrative	Civile	Kundër vajtse	Penale	M	F	Ashkali	Boshnjak	Egjiptian	Goran	Romë	Serb	Shqiptar	Tjeter	Turk	
Pejë	426	212	0	25	278	385	1	27	53	0	39	2	540	0	1	663

Periudhë janar-dhjetor 2014

Komuna e Gjakovës numëron 88 vendbanime

ZRNJF	LËMIA				GJINIA		PËKATËSIA ETNIKE									Nr. i lëndëve
	Administrative	Civile	Kundër vajtse	Penale	M	F	Ashkali	Boshnjak	Egjiptian	Goran	Romë	Serb	Shqiptar	Tjeter	Turk	
Gjakovë	205	63	0	5	112	161	4	2	34	0	3	0	229	1	0	273

Periudhë janar-dhjetor 2014

Komuna e Klinës numëron 54 vendbanime

ZRNJF	LËMIA				GJINIA		PËKATËSIA ETNIKE									Nr. i lëndëve
	Administrative	Civile	Kundër vajtse	Penale	M	F	Ashkali	Boshnjak	Egjiptian	Goran	Romë	Serb	Shqiptar	Tjeter	Turk	
Klinë	130	66	4	28	32	196	0	0	7	0	2	2	217	0	0	228

Periudhë janar-dhjetor 2014

9.1.d. Zyra Rajonale për Ndihmë Juridike Falas – M i t r o v i c ë

Rajoni i Mitrovicë, numëron 6 komuna: Mitrovicë, Vushtrri, Skenderaj, Leposaviq, Zveçan dhe Zubin Potok

Në rajonin e Mitrovicës ekzistojnë tre zyre për ofrimin e ndihmës juridike falas: Një ZRNJF në Mitrovicë, e cila financohet nga Buxheti i Kosovës, një ZNJF në pjesën veriore të Mitrovicës dhe një ZNJF në Skenderaj të cilat deri në maj të vitit 2014 janë mbështetur nga UNDP, ndërsa nga dhjetori i vitit 2014 financohen nga Ambasada Mbretërore e Norvegjisë, me Projektin "Qasja e Barabartë ne Drejtësi".

Komuna e Mitrovicës mbulon 47 vendbanime

ZRNJF	LËMIA				GJINIA		PËKATËSIA ETNIKE									Nr. i lëndëve
	Administrative	Civile	Kundër vajtse	Penale	M	F	Ashkali	Boshnjak	Egjiptian	Goran	Romë	Serb	Shqiptar	Tjeter	Turk	426
Mitrovicë	323	97	0	6	136	290	12	1	0	0	7	1	401	1	3	

Periudhë janar-dhjetor 2014

Zyra në Pjesën Veriore të Mitrovicës

ZRNJF	LËMIA				GJINIA		PËKATËSIA ETNIKE									Nr. i lëndëve
	Administrative	Civile	Kundër vajtse	Penale	M	F	Ashkali	Boshnjak	Egjiptian	Goran	Romë	Serb	Shqiptar	Tjeter	Turk	47
Mit. Veriore	46	1	0	0	20	27	0	0	0	0	5	42	0	0	0	

Periudhë janar-dhjetor 2014

Zyra në Skenderaj mbulon 52 vendbanime

ZRNJF	LËMIA				GJINIA		PËKATËSIA ETNIKE									Nr. i lëndëve
	Administrative	Civile	Kundër vajtse	Penale	M	F	Ashkali	Boshnjak	Egjiptian	Goran	Romë	Serb	Shqiptar	Tjeter	Turk	308
Skenderaj	234	71	2	1	64	244	0	0	0	0	0	0	308	0	0	

Periudhë janar-dhjetor 2014

9.1.e Zyra Rajonale për Ndihmë Juridike Falas – Gj i l a n

Rajoni i Gjilanit numëron 8 komuna: Gjilan, Dardanë (Kamenicë), Viti, Artanë (Novobërdë), Kllokot, Ranillugë dhe Partesh.

Në rajonin e Gjilanit ekzistojnë dy zyre për ofrimin e ndihmës juridike falas: Një ZRNJF në Gjilan, e cila financohet nga Buxheti i Kosovës, dhe një ZNJ në Kllokot, e cila deri në maj të vitit 2014 është mbështetur nga UNDP, ndërsa nga dhjetori i vitit 2014 financohen nga Ambasada Mbretërore e Norvegjisë, me Projektin "Qasja e Barabartë në Drejtësi".

Komuna e Gjilanit numëron 63 vendbanime

ZRNJF	LËMIA				GJINIA		PËKATËSIA ETNIKE									Nr. i lëndëve
	Administrative	Civile	Kundër vajtse	Penale	M	F	Ashkali	Boshnjak	Egjiptian	Goran	Romë	Serb	Shqiptar	Tjeter	Turk	1040
Gjilan	812	199	6	23	420	620	2	6	0	0	30	23	977	1	1	

Periudhë janar-dhjetor 2014

Komuna e Kllokotit numëron4 vendbanime

ZRNJF	LËMIA				GJINIA		PËKATËSIA ETNIKE									Nr. i lëndëve
	Administrative	Civile	Kundër vajtse	Penale	M	F	Ashkali	Boshnjak	Egjiptian	Goran	Romë	Serb	Shqiptar	Tjeter	Turk	67
Kllokot	33	19	3	12	13	54	0	1	0	0	0	17	49	0	0	

Periudhë janar-dhjetor 2014

Klinika mobile

ZRNJF	LËMIA				GJINIA		PËKATËSIA ETNIKE									Nr. i lëndëve
	Administrative	Civile	Kundër vajtse	Penale	M	F	Ashkali	Boshnjak	Egjiptian	Goran	Romë	Serb	Shqiptar	Tjeter	Turk	58
Zyr. Mobile	21	34	0	3	7	51	5	0	0	0	0	0	53	0	0	

Periudhë janar-maj 2014

Veprimet juridike të cilat janë ndërmarr në kliniken mobile në periudhën janar-maj 2014, klinikë kjo e cila është përkrahur nga projekti i UNDP-së.

Totali i lendeve për vitin 2014

ZRNJF	LËMIA				GJINIA		PËKATËSIA ETNIKE									Nr. i lëndëve
	Administrative	Civile	Kundër vajtse	Penale	M	F	Ashkali	Boshnjak	Egjiptian	Goran	Romë	Serb	Shqiptar	Tjeter	Turk	4859
Zyr. Mobile	3188	1454	24	193	3122	1737	31	92	96	34	147	138	4242	6	43	

Agjencia për Ndihme Juridike Falas në Prishtinë dhe zyrat rajonale për ndihme juridike falas, shfrytëzojnë hapësirat e punës në objekte private për të cilat paguan qira mujore,

përveç zyrës rajonale për ndihme juridike falas në Prizren e cila funksionin në objekt publik.

Në Prishtinë ANJF gjendet ne Rr. "Zenel Salihu" nr. 30 dhe shfrytëzon hapësirë prej 300 m2, dhe 50 m2 parking për vetura zyrtare.

Zyrat për Ndihme juridike Falas të cilat janë financohen nga Projekti "Qasja e Barabartë në Drejtësi" funksionojnë ne objekte publike te siguruara nga komunat përkatëse, përveç në Gracanicë dhe Kllokot të cilat janë të vendosura në objekte private

Raporti krahasimor i lëndëve të shqyrtuara në ANJF për periudhën 2012, 2013 dhe 2014 i paraqitur në formë grafike



Raporti krahasimor 2012, 2013, 2014 sipas lëmive juridike



Raporti krahasimor 2012, 2013, 2014 sipas gjinisë



Raporti krahasimor 2012, 2013, 2014 sipas përkatësisë etnike



Raporti krahasimor 2012, 2013, 2014 sipas përkatësisë etnike



Raport krahasimor i lendeve të avokateve për vitet 2012, 2013, 2014

Në periudhën raportuese për vitin 2014, janë angazhuar 308 (treqind e tete) avokatë, duke marrë parasysh që prej muajit maj deri në dhjetor 8 (tetë) zyrat e përkrahura nga Projekti nuk kanë funksionuar, prandaj edhe angazhimi i avokateve ne raport me vitin 2013 është me i vogël.

Mirëpo vlen te theksohet se në vitin 2014 janë realizuar më shumë pagesa të avokateve. Avokatet mund të angazhohen gjatë një periudhe vjetore, ndërsa veprimet mund të i ndërmarrin me vonë, që nënkupton se edhe realizimi i pagesave mund të behët gjatë një viti tjetër fiskal

Gjatë vitit 2014 janë paguar 634 fatura të angazhimit të avokateve.

Raport i Përgjithshëm i lëndëve sipas zyrave 01.01.2014 - 31.12.2014

Grupimi	ZRNF-Prishtinë	ZRNF-Prizren	ZRNF-Pejë	ZRNF-Mitrovicë	ZRNF-Gjilan	ZNJF-Ferizaj	ZNJF-Graqanicë	ZNJF-Dragash	ZNJF-Gjakovë	ZNJF-Klinë	ZNJF-Skenderaj	ZNJF-Mitrovice e Veriut	ZNJF-Kllokot	Zyra Mobile	Total
ADMINISTRATIVE	287	307	426	323	812	228	34	102	205	130	234	46	33	21	3188
CIVILE	291	272	212	97	199	68	27	34	63	66	71	1	19	34	1454
KUNDËRVAJTËSE	1	2	0	0	6	6	0	0	0	4	2	0	3	0	24
PENALE	20	40	25	6	23	26	0	4	5	28	1	0	12	3	193
TOTAL	599	621	663	426	1040	328	61	140	273	228	308	47	67	58	4859
F	251	232	278	136	420	122	22	21	112	32	64	27	13	7	1737
M	348	389	385	290	620	206	39	119	161	196	244	20	54	51	3122
TOTAL	599	621	663	426	1040	328	61	140	273	228	308	47	67	58	4859
Ashkali	8	9	1	12	2	20	0	0	4	0	0	0	0	5	61
Boshnjak	6	48	27	1	6	1	0	0	2	0	0	0	1	0	92
Egjiptian	2	0	53	0	0	0	0	0	34	7	0	0	0	0	96
Goran	1	0	0	0	0	0	0	33	0	0	0	0	0	0	34
Romë	0	53	39	7	30	1	7	0	3	2	0	5	0	0	147
Serb	0	2	2	1	23	1	48	0	0	2	0	42	17	0	138
Shqiptar	572	480	540	401	977	304	5	107	229	217	308	0	49	53	4242
Tjeter	1	0	0	1	1	1	1	0	1	0	0	0	0	0	6
Turk	9	29	1	3	1	0	0	0	0	0	0	0	0	0	43
TOTAL	599	621	663	426	1040	328	61	140	273	228	308	47	67	58	4859
Ref. te Avokatet	65	36	70	29	66	6	3	1	3	13	12	0	4	0	308
TOTAL	65	36	70	29	66	6	3	1	3	13	12	0	4	0	308
Të përfunduara	534	585	593	397	974	322	58	139	270	215	296	47	63	58	4551
Në procedurë	65	36	70	29	66	6	3	1	3	13	12	0	4	0	308

ANJF ka miratuar tarifën për angazhimin e avokateve për çdo veprim juridik, tarifë kjo që është me e ultë se tarifa e avokateve dhe është si në vijim

Lloji i parashtresës		Vlera e çështjes	Numri i pikëve	Vlera e pikës	Gjithsej
1.	Padi, Kërkesa	Deri 100	7		35 €
		Mbi 100	10		50 €
2.	Përmbarimi në bazë të titullit përmbarimor	Deri 100	7		35 €
		Mbi 100	10		50 €

3.	Përmbarimi në bazë të dokumentit të besuar	Deri 100	7	5	35 €
		Mbi 100	10		50 €
4.	Mjetet e rregullta dhe të jashtëzakonshme	Deri 100	12		60 €
		Mbi 100	14		70 €
5.	Përpilimi i parashtresave tjera	Deri 100	3.5		17.50 €
		Mbi 100	5		25 €

I. Përpilimi i parashtresave në procedurën civile dhe procedura të tjera

II. Përfaqësimi në seancat për çështje civile dhe në çështje të tjera

Lloji i çështjes juridike dhe vlera		Vlera e veprimit	Numri i pikëve	Vlera e pikës	Gjithsej
1.	Përfaqësimi në çështje civile dhe të tjera	Deri 100	15	5	75 €
		Mbi 100	20		100 €
2.	Për përfaqësim të palës së dytë, pagesa rritet për 50%	Deri 100	22,5		112,5 €
		Mbi 100	30		150 €
3.	Tre palë e më tepër Limiti i pagesës 200%	Deri 100	30		150 €
		Mbi 100	40		200 €

Vlera e tërësishme e përfaqësimit për një lëndë nuk mund të kalojë shumën prej 500€

Tabelat e mëposhtme ilustrojnë kalkulimin në vlerë monetare të veprimeve juridike, të realizuara nga zyrtarët e ANJF-së, sipas tarifës se ANJF-së dhe sipas tarifës se OAK-së

SHKRESAT	Padi	Ankesa	Kund/Prapsime	Parashtresa	Kerkesa	Këshilla juridike	Tjera	Totali:
Prishtinë	8,950.00 €	1,080.00 €	1,080.00 €	2,375.00 €	1,600.00 €	1,098.00 €	75.00 €	**16,258.00 €**
Prizren	4,400.00 €	8,280.00 €	780.00 €	1,075.00 €	3,225.00 €	477.00 €	2,125.00 €	**20,362.00 €**
Pejë	2,250.00 €	5,340.00 €	60.00 €	1,200.00 €	4,275.00 €	2,070.00 €	225.00 €	**15,420.00 €**
Mitrovicë	2,250.00 €	11,460.00 €	0.00 €	1,000.00 €	875.00 €	756.00 €	25.00 €	**16,366.00 €**
Gjilan	4,750.00 €	23,700.00 €	900.00 €	2,075.00 €	8,100.00 €	225.00 €	525.00 €	**40,275.00 €**
Ferizaj	2,050.00 €	10,860.00 €	1,680.00 €	400.00 €	625.00 €	207.00 €	200.00 €	**16,022.00 €**
Graqanicë	50.00 €	0.00 €	60.00 €	225.00 €	25.00 €	414.00 €	25.00 €	**799.00 €**
Dragash	300.00 €	720.00 €	120.00 €	75.00 €	1,750.00 €	351.00 €	175.00 €	**3,491.00 €**
Gjakovë	1,200.00 €	1,860.00 €	180.00 €	525.00 €	2,600.00 €	702.00 €	200.00 €	**7,267.00 €**
Klinë	450.00 €	2,040.00 €	420.00 €	350.00 €	375.00 €	1,179.00 €	25.00 €	**4,839.00 €**
Skenderaj	400.00 €	15,000.00 €	0.00 €	350.00 €	25.00 €	171.00 €	50.00 €	**15,996.00 €**
Mitro. Veriore	0.00 €	0.00 €	0.00 €	0.00 €	0.00 €	423.00 €	0.00 €	**423.00 €**

Kllokot	300.00 €	1,260.00 €	120.00 €	0.00 €	425.00 €	189.00 €	0.00 €	**2,294.00 €**
Zyra mobile	100.00 €	0.00 €	0.00 €	100.00 €	175.00 €	369.00 €	25.00 €	**769.00 €**
Totali	**27,450.00 €**	**81,600.00 €**	**5,400.00 €**	**9,750.00 €**	**24,075.00 €**	**8,631.00 €**	**3,675.00 €**	**160,581.00 €**

Tabela- Kalkulimi ne vlerë monetare i veprimeve juridike te ndërmarra nga zyrtarët e ANJF-së, sipas tarifës se ANJF-së

SHKRESAT	Padi	Ankesa	Kund/Prapsime	Parashtresa	Kerkesa	Këshilla juridike	Tjera	Totali:
Prishtinë	14,320.00 €	3,060.00 €	3,060.00 €	7,600.00 €	5,120.00 €	3,050.00 €	300.00 €	**36,510.00 €**
Prizren	7,040.00 €	23,460.00 €	2,210.00 €	3,440.00 €	10,320.00 €	1,325.00 €	8,500.00 €	**56,295.00 €**
Pejë	3,600.00 €	15,130.00 €	170.00 €	3,840.00 €	13,680.00 €	5,750.00 €	900.00 €	**43,070.00 €**
Mitrovicë	3,600.00 €	32,470.00 €	0.00 €	3,200.00 €	2,800.00 €	2,100.00 €	100.00 €	**44,270.00 €**
Gjilan	7,600.00 €	67,150.00 €	2,550.00 €	6,640.00 €	25,920.00 €	625.00 €	2,100.00 €	**112,585.00 €**
Ferizaj	3,280.00 €	30,770.00 €	4,760.00 €	1,280.00 €	2,000.00 €	575.00 €	800.00 €	**43,465.00 €**
Graqanicë	80.00 €	0.00 €	170.00 €	720.00 €	80.00 €	1,150.00 €	100.00 €	**2,300.00 €**
Dragash	480.00 €	2,040.00 €	340.00 €	240.00 €	5,600.00 €	975.00 €	700.00 €	**10,375.00 €**
Gjakovë	1,920.00 €	5,270.00 €	510.00 €	1,680.00 €	8,320.00 €	1,950.00 €	800.00 €	**20,450.00 €**
Klinë	720.00 €	5,780.00 €	1,190.00 €	1,120.00 €	1,200.00 €	3,275.00 €	100.00 €	**13,385.00 €**
Skenderaj	640.00 €	42,500.00 €	0.00 €	1,120.00 €	80.00 €	475.00 €	200.00 €	**45,015.00 €**
Mitro. Veriore	0.00 €	0.00 €	0.00 €	0.00 €	0.00 €	1,175.00 €	0.00 €	**1,175.00 €**
Kllokot	480.00 €	3,570.00 €	340.00 €	0.00 €	1,360.00 €	525.00 €	0.00 €	**6,275.00 €**
Zyra mobile	160.00 €	0.00 €	0.00 €	320.00 €	560.00 €	1,025.00 €	100.00 €	**2,165.00 €**
Totali	**43,920.00 €**	**231,200.00 €**	**15,300.00 €**	**31,200.00 €**	**77,040.00 €**	**23,975.00 €**	**14,700.00 €**	**437,335.00 €**

Tabela- Kalkulimi ne vlerë monetare i veprimeve juridike te ndërmarra nga zyrtarët e ANJF-së, sipas tarifës se Odes se Avokatëve për vitin 2014

10. Aktivitetet e Zyrës së Prokurimit për vitin 2014

Lloji i Buxhetit	Nr.i Prokurimit					Titulli i aktivitetit të prokurimit	Data e nënshkrimit të kontratës	Vlera e parashikuar e kontratës	Çmimi i kontratës, duke përfshirë të gjitha taksat etj.	Çmimi i Aneks kontratës, duke përfshirë të gjitha taksat etj.	Emri i OE të cilit i është dhënë kontrata	Selia e OE të cilit i është dhënë kontrata	OE vendor (1) ; Jo vendor (2)	Afati kohor për pranimin tenderëve	Kriteret për dhënjen e kontratës
Të Hyra Vetanake (1) ose Buxh.i Kons.i Kosovës (2) ose Donacion (3)	Numri rendor i prokurimit	Lloji i prokurimit	Vlera e prokurimit	Procedura e prokurimit	Klasifikimi (2 shifrat e para të FPP)									Afati kohor normal (1) Afati kohor i shkurtuar (2)	Çmimi më i ulët (1) Tenderi ekonomikisht më i favorshëm (2)
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13	14	15	16
2	001	1	3	6	21	Furnizimi me material shpenzues të zyrave	24.02.2014	4,500.00	1,978.10	0.00	Blendi	Pr	1	1	1
2	002	2	4	7	34	Mirëmbajtja dhe servisimi iFiat Ducato 2.3	19.02.2014	300.00	120.00	0.00	Kujta	Pr	1	1	1
2	003	2	4	7	34	Furnizimi me ujë të pijës	05.03.2014	650.00	407.08	0.00	Aqua fresh	Pejë	1	1	1
2	004	2	4	7	34	Sigurimi dhe regjistrimi i automjetëve	05.05.2014	2,000.00	665.84	0.00	Illyria	Pr	1	1	1
2	005	5	4	7	45	Kryerja e punëve-riparimi i ZR.në Gjilan		1,000.00	940.00	0.00	Astor AG	Gjilan	1	1	1
2	006	1	3	6	30	Furnizimi me material higjenik	22.05.2014	2,000.00	1,848.00	0.00	BeniDonaPlast	Pr	1	1	1
2	007	1	3	6	23	Furnizimi me derivate;automjete,ngrohje dhe gjenerator	09.06.2014	5,000.00	3,870.30	0.00	Petrol Company	Pr	1	1	1
2	008	2	4	7	93	Pastrimi i automjetëve	09.06.2014	1,000.00	522.47	0.00	AL.Dani	Pr	1	1	1
2	009	1	3	6	30	Furnizimi,servisimi dhe miëmbajtja e TI	04.07.2014	2,500.00	2,634.99	0.00	Infoprint	Pr	1	1	1
2	010	1	3	6	30	Sistemi i alarmit i vend.në objektin e ANJF	04.06.2014	950.00	900.00	0.00	Delta security	Pr	1	1	1
2	011	2	3	6	74	Përkthimi i materialëve	18.06.2014	2,000.00	1,308.00	0.00	Vision	Pr	1	1	1
2	012	2	3	6	50	Servisimi dhe mirëmbajtja e automjetëve	29.09.2014	6,600.00	4,480.00	0.00	Bosch	F.Kosovë	1	1	1
2	013	2	3	6	93	Mirëmbajtja dhe pastrimi i objektit	23.09.2014	4,900.00	3,480.00	0.00	Vetrok	Pejë	1	1	1
2	014	2	3	6	93	Sigurimi fizik i objektit të ANJF	12.08.2014	4,600.00	3,947.45	0.00	Delta security	Pr	1	1	1
2	015	2	4	7	78	Publikimi i njoftimëve	18.06.2014	1,000.00	607.50	0.00	Koha Group	Pr	1	1	1
[Shtoni rreshta aq sa keni nevoj]								0.00	0.00	0.00					
						TOTALI :		**39,000.00**	**27,709.73**	**0.00**					
						TOTALI (10+11) :			**27,709.73**						

11. Auditimi

Agjencia për Ndihmë Juridike Falas menaxhon në mënyrë të pavarur buxhetin e saj, Në këtë vit raportues Zyra e Auditorit të Përgjithshëm (ZAP) ka audituar punën në Agjencinë për Ndihmë Juridike Falas. Pas auditimit, në afat ligjor ZAP-i i ka dërguar ANJF-së raportin e auditimit, ne tabelën e me poshtme pasqyrojmë rekomandimet e ZAP.

Rekomandimi ose gjetja	Veprimi i ndërmarrë ose propozuar	Afati i zbatimit	Efekti
Mungesa e Ftesës për ofertim	Pas pranimit te Raportit të Auditimit ANJF-ja, ka nderrmarr masa të menjëherëshme që të gjitha aktivitetet e prokurimit të cilat zhvillohen të jenë në pajtim të plotë me legjislacionin e aplikueshem në R. e Kosovës	E përfunduar	Është vepruar në pajtim me ligjin
Mosinformimi i OE të pasuksesshëm	Zyra e Prokurimit ka marrë hapat e nevojshëm që në të ardhmën operatorët Ekonomik të pasuksesshem te informohen sipas ligjeve në fuqi	E përfunduar	Është vepruar në pajtim me ligjin
Mungesa e formimit të komisionëve për Pranimin e mallrave	Zyra e Prokurimit ka marrë hapat konkret dhe ka formuar komisionet për pranimin e mallarve	E përfunduar	Është vepruar në pajtim me ligjin

12. Sfidat në Sistemin e Ndihmës Juridike

Agjencinë për Ndihmë Juridike Falas, si institucion të ri, e kanë përcjellë një varg sfidash të ndryshme.

Që nga themelimi e deri më sot, sfidat kryesore për funksionalizimin e një sistemi kualitativ të Ndihmës Juridike në Republikën e Kosovës janë:

1. Sigurimi i buxhetit të qëndrueshëm për të plotësuar nevojat e palëve në sistemin e gjithmbarshëm të Ndihmës Juridike në Republikën e Kosovës.
2. Inkorporimi i 8 (tetë) zyrave për ndihmë juridike në Agjencinë për Ndihmë Juridike Falas si zyre të rregullta për ofrimin e ndihmës juridike. Zyrat për Ndihme juridike Falas në tetë komuna fillimisht janë përkrahur nga UNDP, ndërsa nga dhjetori 2014 deri në qershor 2015, përkrahen nga Projekti "Qasja e Barabartë ne Drejtësi", Ambasada Mbretërore e Norvegjisë
3. Avancimi i kapaciteteve profesionale dhe administrative, në institucionet e sistemit të Ndihmës Juridike.
4. Sensibilizimi dhe vetëdijesimi i publikut, veçmas i grupeve të interesit, interesi i të cilëve ndërlidhet me ndihmën juridike.
5. Hulumtimi dhe gjetja e burimeve financiare nga donatorët e ndryshëm.
6. Shtrirja e drejtë dhe e barabartë e Ndihmës Juridike, në të gjitha regjionet, përkatësisht në të gjitha komunat e Republikës së Kosovës.
7. Edukimi dhe arsimimi i vazhdueshëm kualitativ i personelit të Ndihmës Juridike në Republikën e Kosovës.
8. Implementimi i Planit Strategjik 2015-2019

Për përmbushjen e misionit dhe eliminimin e sfidave, evitimin e pengesave, si dhe mangësive të natyrave të ndryshme, Agjencia për Ndihmë Juridike Falas, duke synuar një sistem të ligjshëm dhe të mirëfilltë të Ndihmës Juridike propozon këto:

13. Rekomandimet

1. Rritja e buxhetit për Agjencinë për Ndihmë Juridike Falas, në përputhje me kërkesat e qytetarëve të cilët kërkojnë ndihmë juridike falas në Republikën e Kosovës.
2. Inkorporimi i 8 (tetë) zyrave për ndihmë juridike falas të cilat deri në qershor të vitit 2015, përkrahën nga Projekti "Qasja e Barabartë në Drejtësi", Ambasada Mbretërore e Norvegjisë
3. Sensibilizimi i vazhdueshëm i institucioneve dhe organeve të Republikës së Kosovës për rëndësinë që duhet kushtuar këtij institucioni.
4. Edukimi dhe ngritja e vetëdijes së qytetarëve për rolin dhe mundësitë që u ofron ANJF-ja.
5. Ngritja e vazhdueshme profesionale e stafit të ANJF-se, për shfrytëzimin e të gjithë mekanizmave ekzistues ligjor për ndihmë juridike.
6. Sigurimi i hapësirave të punës për ANJF, në objektet publike